POSTIM ARKIVOR

Jup Kazazi (1909–1946)



SEKSIONI

Kufiri Shkoder

PERIUDHA

1944 - 1946

Lindi në Shkodër dhe u angazhua në jetën politike e administrative gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore. Ai punoi në Ministrinë e Financave dhe, për një periudhë të shkurtër, mbajti detyrën e ministrit në qeverinë e Mustafa Krujës. Më pas dha dorëheqjen dhe vijoi veprimtarinë e tij në radhët e nacionalistëve. Ishte një nga drejtuesit kryesorë të Kryengritjes së Postribës, lëvizjes së armatosur kundër regjimit komunist, e zhvilluar më 9 shtator 1946 në zonën e Postribës, pranë Shkodrës. Kryengritja synonte kundërshtimin e regjimit të ri komunist dhe politikave të tij në Shqipërinë e pasluftës. Ajo u shtyp nga forcat qeveritare brenda një kohe të shkurtër dhe u pasua nga arrestime, hetime dhe masa ndëshkuese ndaj pjesëmarrësve dhe personave të dyshuar si mbështetës të saj. Pas shtypjes së kryengritjes, Jup Kazazi u tërhoq në zonat malore. Më 17 shtator 1946, pasi u rrethua nga forcat qeveritare, vetëvritet për të shmangur rënien në duart e forcave komuniste. Emri i tij lidhet ngushtë me organizimin dhe drejtimin e Kryengritjes së Postribës, një nga ngjarjet e rëndësishme të kundërshtimit të armatosur ndaj regjimit komunist në vitet e para të pasluftës.

PERMBAJTJE #1


Jup Kazazi : nga veprimtaria politike te Kryengritja e Postribës

Jup Kazazi lindi në Shkodër më 1909. Kreu studimet për ekonomi fillimisht në Beograd dhe më pas në Torino, Itali. Gjatë veprimtarisë së tij ushtroi funksione në administratën shtetërore dhe në jetën politike të kohës. Gjatë pushtimit italian të Shqipërisë, Kazazi u angazhua në administratën shtetërore dhe në strukturat e Partisë Fashiste Shqiptare, ku mbajti edhe detyrën e ministrit. Më pas dha dorëheqjen nga kabineti, së bashku me Hasan Dosti, dhe iu bashkua veprimtarisë së Ballit Kombëtar. Në vitin 1946, Kazazi u përfshi në kryengritjen e Postribës, një lëvizje e armatosur kundër regjimit komunist, e zhvilluar në zonën e Postribës, pranë Shkodrës. Pas shtypjes së kryengritjes nga forcat e regjimit, pasuan arrestime, ndjekje dhe dënime ndaj personave të përfshirë. Më 17 shtator 1946, gjatë një operacioni rrethimi në Bërdicë, Kazazi vrau veten për të shmangur kapjen, ndërsa vëllezërit e tij u dënuan me vdekje nga autoritetet e regjimit komunist. Në Dosjen Formulare nr. 211 nga arkivi i AIDSSH, ndodhen shënime të shkruara me dorë nga Jup Kazazi, me titull “Shënime mbi jetën time private dhe politike tuj fillue prej fëmijnije e deri sod me 1 Prill 1934”. Gjithashtu, evidentohen dokumente dhe korrespondencë që lidhen me veprimtarinë e Kazazit në kuadër të Ballit Kombëtar. Ndër to përfshihen komunikime me Mid’hat Frashërin dhe Jusuf Luzajn, lidhur me organizimin e veprimtarisë nacionaliste, si dhe kontakte me misionin ushtarak britanik në Shqipërinë e Veriut gjatë viteve 1943–1944.

MEDIA #1

Komunikim i Ballit Kombëtar drejtuar Jup Kazazit

MEDIA FAQE #1



Z . KAZAZI.

Jemi të mejtimit që gjithë automobilat kamiona ose vetura
që shkojnë për në Kosovë të ndalohen dhe të kontrallohen.
Të ndalohen në mënyrë konfiskimi ata të komunistave dhe
të na lajmëroni ne procesat përkatëse. Pa lejen t'onë mos leni
me kalue asnji automobil: të kërkohet leja e komandës Kryeqytet
it.

Të ndalet dhe t'i merret automobil veturë me këtë numër:
" TIRANË Nr I49. Shoferi i kësaj maqine asht shum i rrezikeh
shëm, në qoftë se kapet mos të lirohet.

BALLI KOMBËTAR.

Komanda e Kryeqytetit

BALLI KOMBETAR
KOMANDA E KRYEQYTETIT

Komunikim i Ballit Kombëtar drejtuar Jup Kazazit

INFORMACION

Komunikim i Ballit Kombëtar drejtuar Jup Kazazit

FONDI	Operativ
KUTIA	Nr. 17
DOSJE	Formulare
NR. DOSJES	211
VITI	1945


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #2

Komunikim i Midhat Frashërit drejtuar Jup Kazazit lidhur me komunikimin me krerët nacionalistë në Vlorë dhe Shijak, datë 03.11.1944

MEDIA FAQE #1



BALLI KOMBËTAR

Komiteti Qendruer

SHQIPËRIJA E SHQIPËTARVET
VDEKJE TRATHTARVET

Numri 581

Shqipni e Lirë, 3 - 11 - 1944.

I dashur Zoti Jup Kazazi

Me qenë se do të rrini në Malsinat e Shkodrës, ju lutem të kini kujdes të hyni në korespondencë me krenat e fuqivet nacionaliste që gjinden në Vlorë e Shijak, emrat e të cilëvet do t'i gjeni në listën këtu poshtë.

Këta janë burra që kanë dhënë prova të gjalla për ndjenjat e tyre nacionaliste dhe të cilët mund të paraqiten si grumbull përpara fuqivet aleate, kur të çbarkojnë në Shqipëri.

Ju urojmë punë të mbarë dhe të vlefshme për Shqipërinë dhe sukses.

Të fala
Kryetari
(Midhat Frashëri)

Burrel - Shijak
Kap. Meleq Frashëri
Major Dushmani
Mehmet Kapllani
Kap. Bajram Kokla
Major Kasapi Zhepova
Nam Gërguri
Hasbi Mataka
Gani Mirako
Kap. Enver Vrioni
Togen Hysni Mamaqi
Togen Malig Gjuraziqi
Kap. Murie Baxha
Togen Jusuf Gjoni
Cana Dushari
Vlorë
Major Tahsin Gjinishi
Kap. Jusuf Shehu
Maliq Koshena
Beqo Hyseni
Tahir Kuroka

AIDSSH

Komunikim i Midhat Frashërit drejtuar Jup Kazazit lidhur me komunikimin me krerët nacionalistë në Vlorë dhe Shijak, datë 03.11.1944

INFORMACION

Komunikim i Midhat Frashërit drejtuar Jup Kazazit lidhur me komunikimin me krerët nacionalistë në Vlorë dhe Shijak, datë 03.11.1944

FONDI	Operativ
KUTIA	Nr. 17
DOSJE	Formulare
NR. DOSJES	211
VITI	1945


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #3

Komunikim i Midhat Frashërit drejtuar Jup Kazazit lidhur me takimin dhe bashkëpunimin me misionin ushtarak britanik, datë 07.08.1944

MEDIA FAQE #1



BALLI KOMBËTAR

Komiteti Qendruer

43

SHQIPËRIJA E SHQIPËTARVET
VDEKJE TRAITHTARVET

Numri 485

Shqipni e Lirë, 7 - 8 - 1944.

Zotit Ejup Kazazit

Shkodër

I dashuai Zoti Kazazi,

Simbas lajmit qi ma keni dhanë se në Prefekturën e Shkodrës ndodhet aji mision ushtarak Britanik,me të cilin qenka edhe miku i ynë Z.Major Neel-i,ju lutem qi zotnija e juej të shkoni dhe të bisedoni me 'te,si përfaqësues i organizatës,dhe të merrni vesht për aji bashkëpunim të agushtë në interes të Shqipnisë.Për këte punë punë mund të këshilloheni dhe me ZZ.Zef Palin,sekretarin e Komitetit Qendruer,e Lec Kurtin,kryetarin e Komitetit t'onë Krahinuer aty,me të cilët jemi pamë dhe kemi bisedue,tue u dhanë udhëzimet e nevojshëme.

Simbas bisedimevet qi të kemi,lutem të na lajmoni.

Kryetari
(Midhat Frashëri)
Midhat Frashëri

BALLI KOMBËTAR · KOMITETI QENDRUER ·

AIDS

Komunikim i Midhat Frashërit drejtuar Jup Kazazit lidhur me takimin dhe bashkëpunimin me misionin ushtarak britanik, datë 07.08.1944

INFORMACION

Komunikim i Midhat Frashërit drejtuar Jup Kazazit lidhur me takimin dhe bashkëpunimin me misionin ushtarak britanik, datë 07.08.1944

FONDI	Operativ
DOSJA	Formulare
NR. DOSJES	211
VITI	1945


TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.

MEDIA #4

Komunikim i përfaqësuesit të Komitetit Qendror, Jusuf Luzaj, drejtuar Jup Kazazit për mbledhjen në Komunën e Rrjollit, datë 28.11.1943

MEDIA FAQE #1



BALLI KOMBETAR.

Komiteti qendruer.

Komandantit të çetës z. Jup Kazazi

Kopliku

Jeni të lutun të mbaheni me faqitë e juaja në këtundin Gruemirë të komunës së Rjollit, me datën 28 Tetuer 1943 para dreke.

Me rastin e këj inspektimi që do të kryhet, dahet të përfundojë riorganizimi i sekcioneve të ndryshme dhe i qhtabit, prandaj ne merrë no rrë masat dhe elemntat e nevoshme per këtë punë.

Përfaqsues i Komitetit Qendruer

(Prof. Jusuf Luzaj)

Yusuf Luzaj

Zonë e Lirë, më 25.X.1943

Komunikim i përfaqësuesit të Komitetit Qendror, Jusuf Luzaj, drejtuar Jup Kazazit për mbledhjen në Komunën e Rrjollit, datë 28.11.1943

INFORMACION

Komunikim i përfaqësuesit të Komitetit Qendror, Jusuf Luzaj, drejtuar Jup Kazazit për mbledhjen në Komunën e Rrjollit, datë 28.11.1943

TRANSKRIPT

Nuk ka transkript per kete media.